

Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi nismën KOMRA

Serbi, Ivanjica
21 shtator 2008

Konsultat i organizoi Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut (Serbi). Të rinjtë e përkrahin nismën rajonale për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës dhe konsiderojnë se duhet të themelohet KOMRA si komision zyrtar.

Komisioni Rajonal duhet të jetë i paanshëm dhe tmerrsisht objektiv në punën e tij, dhe vetë procesi i themelimit duhet të planifikohet mirë.

Të rinjtë konsiderojnë se është e domosdoshme fushata për krijimin e klimës pozitive në shoqëritë e ish RFSJ dhe se ajo duhet të përfshijë target grupet e ndryshme me qasje të përshtatur secilës prej tyre. Fushata duhet të jetë e shkallëzuar, duhet të përfshijë viktimat, familjet e tyre dhe duhet të theksohet nevojia për të vërtetën.

Në fushatë duhet të kyçen personalitetet publike nga fushat e ndryshme.

Edukimi ka rol të rëndësishëm në krijimin e klimës pozitive, si dhe bashkëpunimi rajonal dhe posaçërisht këmbimi i vizitave të të rinjëve.

Është e domosdoshme që të krijohet lidhje mes brezave, ndërmjet viktimave dhe të rinjëve, në mënyrë që tek të rinjtë të zhvillohet empatia. Është me rëndësi që të organizohen vizitat përmendoreve dhe vendeve të krimeve.

Të rinjtë e shohin rolin e tyre në angazhimin në terren, së bashku me viktimat. Të rinjtë duhet ta ndërrojnë rrethin e tyre nga përditshmëria.

Është e domosdoshme që të kyçen bashkësitë fetare – paria e kishës duhet të prejellë dëshmitë publike dhe të kyçet maksimalisht në procesin.

Për anëtarë të Komisionit nuk do të duhej të zgjedheshin njerëzit që janë të lidhur me pushtetin ose që kanë qenë në pushtet në kohën e konflikteve të armatosur në ish RFSJ.

Të rinjtë përkrahin viktimat dhe anëtarët e familjeve që të bëjnë dëshmi publike dhe konsiderojnë se përgatitja, dëgjimi dhe bartja e dëshmimeve të viktimave duhet të bëhet me kujdes të madh duke pasur konsiderata për dinjitetin dhe dëshirat e viktimave.

Të rinjtë si anëtarë të komisionit shohin personalitetet publike dhe qytetarët akademikë, dhe sidomos përfaqësuesit e viktimave dhe të familjeve të tyre. KOMRA duhet të ketë kompetencat e definuara qartë për hetime. Organet shtetërore, duke përfshirë shërbimet e sigurimit, duhet të bashkëpunojnë me KOMRA.